



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Në mbështetje të nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi 2004/04 dhe bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/19, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për unifikimin dhe standardizimin e dokumenteve shëndetësore në Institucionet Shëndetësore, nxjerrë këtë:

Udhëzim Administrativ (në Shëndetësi) Nr.02/2010
Dokumentet Shëndetësore

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është unifikimi dhe standardizimi i dokumenteve shëndetësore në institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, në shërbimet specialistike-konsultative dhe diagnostike të Kujdesit Parësor, Kujdesit Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor.

Neni 2
Fusha e Zbatimit

Ky Udhëzim Administrativ përcakton formën e dokumenteve, mënyrën dhe personat përgjegjës për plotësimin dhe administrimin e tyre në të gjitha institucionet shëndetësore.

Neni 3
Përkufizimi

1. Për qëllim të këtij Udhëzimi, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Dokumentet shëndetësore**, janë dokumentët ku evidentohen të dhënat e përgjithshme dhe të veçanta të pacientit, punëtorit shëndetësor dhe institucionit shëndetësor.
 - 1.2. **Punëtorët shëndetësorë** që plotësojnë dokumentët shëndetësore janë: Doktorit i Mjekësisë, Specialisti i Mjekësisë Familjare, Mjeku Konsulent, Infermieri, Laboranti;
 - 1.3. **AMF-Ambulanca e Mjekësisë Familjare**

- 1.4. **KPSH**-Kujdesi Parësor Shëndetësor
- 1.5. **KDSh**-Kujdesi Dytësor Shëndetësor
- 1.6. **KTSh**-Kujdesi Tretësor Shëndetësor
- 1.7. **QKUK**-Qendra Klinike Universitare e Kosovës
- 1.8. **QKMF**-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- 1.9. **QMF**-Qendra e Mjekësisë Familjare
- 1.10. **ShShM**-Shërbimet e Shëndetit Mendor

Neni 4 Dokumentet

1. Dokumentet Shëndetësore të unifikuara dhe standardizuara sipas thirrjes dhe shifrimit janë:

1.1. Udhëzimi për Konsultim	DM0101
1.2. Raporti nga Konsulta	DM0102
1.3. Udhëzim për Hulumtime Diagnostike	DM0103
1.4. Raporti Kthyes nga Diagnostika	DM0104
1.5. Raporti kthyes nga Laboratori/gjak, urinë, feces	DM0105
1.6. Raporti kthyes nga Laboratori/hormone	DM0106
1.7. Urdhëresë për Dhënien e Terapisë Parenterale	DM0108
1.8. Vërtetim për Nxënës dhe Student	DM0109
1.9. Regjistri i Pacientëve	DB02
1.10. Regjistri i Kartotekës	DB03
1.11. Regjistri i Përdoruesve të Narkotikëve dhe Substancave psikotrope	DB04

Neni 5 Përmbajtja e Dokumenteve Shëndetësore

1. Dokumentet Shëndetësore nga Neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 dhe 1.9, përbëhen nga:
 - 1.1 Pjesa e përgjithshme ku përfshinë të dhënat për institucionin, mjekun dhe pacientin.
 - 1.2 Pjesa e veçantë ku përshkruhen diagnoza, terapia, procedurat mjekësore, nënshkrimi dhe faksimili i punëtorit shëndetësor.
2. Dokumentet Shëndetësore nga Neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 dhe 1.11 përbëhen vetëm nga pjesa e përgjithshme

Neni 6 Tiparet e Dokumenteve Shëndetësore

1. **Udhëzim për konsultim**
Formati 21x29.7cm, shtypi një ngjyrësh, i dyanshëm me numeracion, faqja e pasme është Raporti nga Konsulta.
2. **Raport nga konsulta**
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh

3. **Udhëzim për hulumtime diagnostike**
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i njëanshëm
4. **Raport kthyes nga diagnostika**
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i njëanshëm
5. **Raport kthyes nga laborator**^{/gjaku, urina dhe fecesi}
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i dyanshëm
6. **Raport kthyes nga laborator**^{/hormonet}
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i dyanëshem
7. **Urdhëresë për dhënien e terapisë parenterale**
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i dyanëshem
8. **Vërtetim për Nxënës dhe Student**
Formati 21x29.7cm, shtypi njëngjyrësh, i njëanshëm
9. **Regjistri i përdoruesve të narkotikve dhe substancave psikotrope**
Libër me lidhje të fortë, formati 25x35cm,
Kopertina: karton i presuar me trashësi 2.25mm e veshur me pëlhurë
Ngjyra e kuqe e mbyllët, shkronjat ngjyrë të bardhë
Shtypi njëngjyrësh, i dyanëshem
10. **Regjistri i kartotekës**
Libër me lidhje të fortë, 21x29.7cm
Kopertina: karton i presuar me trashësi 2.25mm e veshur me pëlhurë
Ngjyra e gjelbër e mbyllët. Shkronjat me ngjyrë të bardhë.
Shtypi njëngjyrësh, i dyanshëm
11. **Regjistri i pacientëve**
Libër me lidhje të fortë, formati 25x35cm
Kopertina: karton i presuar me trashësi 2.25 mm e veshur me pëlhurë
Ngjyra e kaltër e mbyllët. Shkronjat ngjyrë të bardhë.
Shtypi njëngjyrësh, i dyanshëm

Neni 7

Përdorimi i dokumenteve shëndetësore në Institucionet shëndetësore

- 1 Dokumentet Shëndetësore përdoren në institucionet shëndetësore të KPSH ne: QKMF, QMF, AMF dhe njësitë e tyre organizative,
 - 1.1 Dokumentet Shëndetësore nga neni 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.3, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.11 përdoren në Departamentin e Mjekësisë Familjare
 - 1.2 Dokumentet Shëndetësore nga neni 4, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.6 përdoren në shërbimet specialistike-konsultative, diagnostike dhe laboratorike, KPSH, KDSH dhe KTSh.